



НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
KËSHILLI KOMBËTAR I PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY



KËSHILLI NACIONAL I PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE NË REPUBLIKËN E SERBISË

Raporti i Këshillit Nacional të Pakicës Kombëtare Shqiptare mbi zbatimin e Kartës
Evropiane për Gjuhët Rajonale apo Minoritare

Bujanoc, Dhjetor 2013

Këshilli nacional i pakicës kombëtare shqiptare, Karagjorgje Petroviq 237, 17520 Bujanoc, Republika e Serbisë
Tel/fax: 00381 17 653 264, e-mail: keshillikombetarshqiptar@gmail.com



RAPORTI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE MBI ZBATIMIN E KONVENTËS EVROPIANE PËR GJUHËT RAJONALE OSE MINORITARE

Dhjetor, 2013

Themelimi i Këshillit kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare

Këshilli nacional i pakicës kombëtare shqiptare (në tekstin në vijim: Këshilli) është themeluar më datë 3 qershor 2010 në një situatë tepër të vështirë duke ju falënderuar ambasadave të huaja, misionit të OSBE-së dhe institucioneve tjera relevante ndërkombëtare.

Këshilli kombëtar numëron 29 anëtarë, 6 komisione me nga 15 anëtarë dhe nënkomisione tjera, organi ekzekutiv numëron 9 anëtarë, kurse në administratën e Këshillit janë të punësuar 7 persona.

Arsimi

Sigurisht se sfida më e madhe gjatë aktivitetit të Këshillit është sigurimi i librave në gjuhën shqipe për nxënësit parashkollor, shkollave fillore dhe atyre të mesme.

Si rezultat i punës së Këshillit 63 tekste për shkolla fillore janë lejuar për botim, prej të cilave 45 janë tekste dhe 18 fletore pune. Nga këto, 18 tekste dhe fletore pune janë nga Shqipëria, 10 tekste dhe fletore nga autorët lokal dhe 35 tekste dhe fletore të përkthyer nga Këshilli.

Librat e gjuhëve të huaja nuk janë përfshirë në këtë numër për arsye se ato janë të përbashkëta për të gjitha pakicat në Serbi.

Këshilli ka numër të madh kërkesash ndaj Ministrisë së arsimit të Republikës së Serbisë për të lejuar për përdorim nga Shqipëria këto tekste shkollorë: biologji, kimi, histori, art figurativ, kulturë muzikore dhe gjeografi.

Nga ana e Ministrisë së arsimit nuk respektohet ligji lidhur me përfshirjen e kulturës, identitetit dhe historisë shqiptare (deri në 30%) në planprogramet mësimore për lëndët: histori, gjeografi, arti figurativ dhe kulturë muzikore.

Nuk ekziston strategjia koherente shtetërore për avancimin e mësimdhënësve në gjuhët e pakicave, kurse përkujdesjen për avancimin e kadrove arsimore kryesisht e ka marrë Këshilli. Gjithashtu, nuk ekziston praktika për angazhimin e mbikëqyrësve shkollor për mësimin në gjuhën e pakicave kombëtare.



Pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare, në pamundësi të shkollimit në gjuhën e vetë amtare në Serbi, janë të obliguar t'i vazhdojnë studimet e larta në universitetet e Shqipërisë dhe Kosovës. Të diplomuarit e disa drejtimeve nga universitetet e lartpërmendura nuk kanë mundësi të themelojnë marrëdhënie pune për shkak të procesit të stërzgatur të nostrifikimit të diplomave në institucionet përkatëse në Serbi, çka paraqet vështirësi shtesë, veçanërisht në institucionet edukativo-arsimore, në realizimin e plan-programit shkollor me kuadro të kualifikuara.

Injorimi i Këshillit i cili mbulon fushat e parapara me Ligjin mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare, paraqet pengesë serioze në realizimin e kompetencave të parapara me ligjin e lartpërmendur.¹

Deri në momentin e paraqitjes të këtij raporti librat amëz të nxënësve, ditarët, dëftesat etj. në shkolla ku mësimi mbahet në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj janë vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik edhe pse ekziston detyrimi që evidenca të mbahet edhe në gjuhën shqipe.

Konsiderojmë se është me rëndësi të përmendim edhe rastin e „Shkollës së muzikës“ në Bujanoc ku mësimi mbahet vetëm në gjuhën serbe dhe për cilën gjë ne si Këshill gjatë muajit shkurt 2013 kemi kërkuar nga komuna e Bujanocit që të iniciojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të kësaj shkolle në mënyrë që të bëhet e mundur mbajtja e mësimit edhe në gjuhën shqipe për nxënësit e përkatësisë kombëtare shqiptare, sikur edhe për institucionet kulturore komunale dhe bibliotekat e qyteteve – të komunës së Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës.² Ndërkohë, edhe pse kuvendet e komunave të lartpërmendura kanë mbajtur disa seanca, deri në këtë moment kur sjellim këtë raport, ky propozim nuk ka qenë si pikë e rendit të ditës, me çka po e pengojnë realizimin e të drejtave të garantuara për pakicat kombëtare të pashikuara me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të Republikës Serbisë.

Në Republikën e Serbisë ekzistojnë 15 shkolla fillore në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe, prej të cilave shtatë janë në Preshevë, gjashtë në Bujanoc dhe dy në Medvegjë. Shkolla të mesme të cilat organizojnë mësim në gjuhën shqipe janë gjithësejtë katër, prej të cilave dy janë në Preshevë, një në Bujanoc dhe një në Medvegjë. Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme është mbi 10.000 (dhjetë mijë).

¹ Aktgjykimi i Gjykatës Administrative, nr.II-2 U.779/13 më datë 23.05.2013.; dhe Aktvendimi i Ministrisë arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, nr. 119-01-00008/2013-03/23/3 dt. 22.04.2013., 119-01-00008/2013-03/15/2 dt. 22.04.2013. dhe tj, si dhe mbikëqyrja inspektuese e inspektoratit republikan arsimor, nr. 614-02-00988/2012-12 dt. 08.02.2013g., 424-614-00024/2013-07 dt. 11.03.2013g.

² Shkresa dërguar kuvendit komunal të Preshevës, nr. 125/2013; Bujanoc, nr. 126/2013 dhe Medvegjës, nr.124/2013 dt. 11.04.2013.



Vlen të theksohet se Këshilli në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik të Republikës Serbisë, misionin e OSBE-së, Trupin koordinues të qeverisë së Serbisë për komunat Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë dhe me Universitetin e Novi Sadit, kanë arritur ta hapin paralelen e Fakultetit ekonomik të Suboticës në Bujanoc dhe në këtë mënyrë është bërë hapi i parë në kuptimin e realizimit të të drejtave kolektive për shkollim të lartë, duke pasur parasysh nevojën e hapjes edhe të drejtimeve tjera.

Kultura

Pas konstituimit të Këshillit, ne, si institucion kemi marrë përkujdesjen për avancimin e identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor e fetar të pakicës kombëtare shqiptare, konkretisht me zhvillimin e kushteve të nevojshme për avancimin e identitetit.

Kemi investuar potencial të madh në këtë fushë, por për fat të keq për shkak të kufizimit të mjeteve materiale me të cilat disponojmë, nga njëra anë, si dhe për shkak të mungesës bashkëpunimit të komunave dhe institucioneve tjera relevante shtetërore me Këshillin, në anën tjetër, deri tash nuk i kemi arritur synimet dhe qëllimet në kuptimin institucional të parapara në strategjinë për realizimin e të ashtuquajturës autonomi kulturore.

Siç e kemi përmendur komuna e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës kanë bibliotekat e qytetit, por numri i librave në gjuhën shqipe është shumë i vogël. Ministria e kulturës dhe informimit e Republikës Serbisë deri tash nuk ka siguruar librat në gjuhën shqipe për bibliotekat e lartpërmendura, ndërsa nga ana tjetër ekzistimi i barrierave kufitare për importimin e librave nga shtetet tjera, si edhe mungesa e shtëpive botuese për botimin e librave në gjuhën shqipe janë reflektuar në fondin e vogël të librave.

- Në procedurë është hapja e “Muzeut etnografik” i bashkësisë shqiptare në Republikën e Serbisë;
- Është treguar nevoja për formimin dhe afirmimin e “Teatrit amator” në institucionet kulturore të komunës së Bujanocit dhe të Preshevës;
- Institucionet kulturore të themeluara nga administrata komunale bashkëpunojnë shumë pak me Këshillin, edhe pse këto institucione publike nga ana e Këshillit me Vendim janë përcaktuara si të rëndësishme së veçantë për ruajtjen, avancimin dhe zhvillimin e veçorive të identitetit kulturor kombëtar të bashkësisë shqiptare;³

³ Vendimi mbi pëcaktimin e institucioneve publike të rëndësishme së veçantë për ruajtjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit kulturor kombëtar të bashkësisë shqiptare, të publikuara në “Gazetën zyrtare RS” nr.118/2012 dt. 15.12.2012.



- Për shkak të mungesës së marrëveshjeve bilaterale të Republikës Serbisë me Republikën e Shqipërisë dhe të Kosovës, ne, si Këshill, nuk kemi mundësi të realizojmë bashkëpunim kulturor me organizatat e shtetit amë.

Informimi

Në kuptim të nenit 11 të Kartës evropiane për gjuhët rajonale ose minoritare, Këshilli nacional në fushën e informimit konsideron që në nivel lokal gjendja është e mirë, duke pasur parasysh që duhet të funksionojnë mediet informative lokale, siç janë: Radiotelevizioni Presheva dhe RTB Bujanoci, si dhe Radio Presheva dhe Radio Bujanoci. Gjithashtu, në Preshevë funksionon edhe televizioni privat TV Aldi i cili emiton program vetëm në gjuhën shqipe si dhe RTV Spektri në Bujanoc i cili, gjithashtu, emiton program vetëm në gjuhën shqipe.

E vetmja revistë javore në gjuhën shqipe është “Nacionali”, i cili është sjellë në situatë të ndërpres botimin për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Vlen të theksohet që në fillim të botimit, këtë revistë javore e ka përkrahur Ministria e kulturës e Republikës së Serbisë, por pas mbarimit të projektit, kemi filluar ta botojmë me mjete vetanake e të cilat nuk janë të mjaftueshme.

Ministria kulturës dhe informimit e Republikës së Serbisë nuk ka krijuar sigurinë juridike për aplikimin e Konventës europiane për gjuhët rajonale ose minoritare si dhe aplikimin e masave mbrojtëse afirmative, në kuptimin e realizimit të drejtës për informim të pjesëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare, sepse në periudhën prej vitit 2009 deri 2011 çdo vit është ndryshuar mënyra e bashkëfinancimit për ruajtjen e revistës në gjuhën e pakicës kombëtare shqiptare. Me ndërprerjen e plotë të bashkëfinancimit për ruajtjen e një reviste të vetme në gjuhën shqipe në vitin 2012 janë shkelur parimet kushtetuese dhe ligjore që i garantojnë status dhe mbrojtje juridike të barabartë përfaqësuesve të pakicës kombëtare shqiptare.⁴

Me Ligjin mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare⁵ („Fletorja zyrtare RSJ“, nr 11/02, “Fletorja zyrtare SCG”, nr 1/03 – Konventa kushtetuese dhe “Gazeta zyrtare e RS”, nr 72/09 – ligjet tjera dhe 97/2013 – vendimi i Gjykatës kushtetuese) me dispozitat e nenit 17, paragrafi 2 është paraparë që shteti në programet e radiove dhe televizioneve të kanalit publik të sigurojë program informativ, kulturor dhe arsimor në gjuhën e pakicës kombëtare. Ligji mbi radiodifuzionin⁶ parasheh, ndër të tjera, që programet të cilat realizohen dhe emiten brenda

⁴ Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS, nr. 16-2568/11 me datë 18.06.2012.

⁵ „Fletorja zyrtare RSJ“, nr 11/02, “Fletorja zyrtare SCG”, nr 1/03 – Karta kushtetuese dhe “Gazeta zyrtare e RS”, nr 72/09 – ligjet tjera dhe 97/2013 – vendimi i Gjykatës kushtetuese, nr. 97/2013.

⁶ „Gazeta zyrtare RS“, nr. 42/2002, 97/2004, 76/2005, 79/20 05, 62/2006, 85/2006 i 86/2006.



radiodifuzionit publik duhet të sigurojnë llojlloshmërinë dhe balancimin e përmbajtjes me të cilat mbështeten vlerat demokratike bashkëkohore, veçanërisht respektimin e drejtave të njeriut, të drejtat kulturore, nacionale, etnike dhe pluralizmit politik të ideve dhe mendimeve. Institucioni Radiodifuziv, Radio Televizioni i Serbisë, brenda kompetencave të veta obligohet të emitojë program për kulturën, gjuhën, zakonet, historinë dhe karakteristikat tjera të pakicës kombëtare shqiptare e cila jeton në Serbi, ashtu që përfaqësuesit e pakicave kombëtare të arrijnë të drejtën e tyre për informim në gjuhën amtare.⁷

Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj

Deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti organet republikane nuk kanë filluar përkthimin dhe publikimin e ligjeve më të rëndësishme në gjuhën shqipe. Organet kompetente republikane në frymën e Kartës, duhet të shqyrtojnë publikimin e “Gazetës zyrtare të Republikës së Serbisë” në gjuhën shqipe, para së gjithash atyre ekzemplarëve të cilët përmbajnë materie të rëndësishme ligjislative për këtë pakicë. Ekzistojnë raste të veçanta të përkthimit të tekstit të disa ligjeve caktuara, p.sh. Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare nga ana e Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe pakicave. Në bazë të asaj që theksuam më lart, konsiderojmë që konkretisht në nivel republikan, ku nxirren aktet më të rëndësishme, mungon publikimi i tyre i rregullt në gjuhën shqipe nga ana e organeve kompetente republikane, ndërsa pa përkthimin zyrtar të ligjeve është vështirë të mendohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj në organet e administratës dhe në gjykata.

Në bazë të nenit 3 të Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare, Ministria përkatëse për të drejtat e njeriut dhe pakicave (aktualisht Ministria e drejtësisë dhe administratës shtetërore) mban regjistrat e këshillave kombëtare. Regjistrimi në regjistër bëhet në bazë të kërkesës për regjistrim të cilën kryetari i Këshillit nacional e paraqet në afat prej 30 ditë nga dita e konstituimit të Këshillit. Me regjistrimin në regjistër këshilli nacional arrin statusin e personit juridik. Siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare dhe Rregullores mbi përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së regjistrave të këshillave nacionale të pakicave kombëtare⁸ nuk është parashikuar që emërtimi i Këshillit nacional të shënohet në Regjistër edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare konkrete. Ne si Këshill konsiderojmë që dispozitat e lartpërmendura nuk janë në pajtim me frymën e Kartës evropiane për gjuhët rajonale ose minoritare dhe koha po tregon se institucionet relevante shtetërore duhet të bëjnë plotësimin dhe ndryshimin e këtyre akteve dhe në këtë mënyrë Këshillave nacionalë të pakicave

⁷ Rekomandimi i Komisionerit për mbrojtjen e barazisë i RS, nr. 306/2001 me datë 01.12.2011.

⁸ „Gazeta zyrtare e RS“, nr. 91/2009.



kombëtare t'i mundësohet që shënimi në Regjistër të bëhet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare të cilën e përfaqësojmë.

Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare me miratimin e Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare⁹, ka marr përsipër kompetenca të rëndësishme në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip. Në pajtim me këtë ligj, Këshilli nacional përcakton emërtimet tradicionale të njësive të vetëqeverisjes lokale, të vendbanimeve, të toponimeve dhe emërtimeve tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare shqiptare, sepse në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ose vendeve tjera të banuara gjuha shqipe është në përdorim zyrtar; emërtimet të cilat janë të përcaktuara nga Këshilli nacional bëhen emërtime në përdorim zyrtar krahas emërtimeve në gjuhën serbe.¹⁰

Meqë në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës jetojnë numër i konsiderueshëm i qytetarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare dhe në këtë drejtim në kuptimin formalo juridik përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit shqip si gjuhë e barabartë krahas gjuhës serbe dhe shkrimit cirilik është përcaktuar me Statutin e komunës së Bujanocit¹¹, Statutin e komunës së Preshevës¹², si dhe me Statutin e komunës së Medvegjës¹³. Mirëpo, edhe përkundër këtij detyrimi statutar, organet e administratës komunale të komunave të lartpërmendura komunikimin zyrtar me shkrim nuk e bëjnë në gjuhën shqipe me qytetarët e përkatësisë kombëtare shqiptare, përkatësisht aktet administrative të cilat i sjellin nuk janë në gjuhën shqipe. Për të tejkaluar këtë problem, në këto administrata (Preshevë dhe Bujanoc) është më se i nevojshëm themelimi i një shërbimi të veçantë përkthyesish (meqenëse numri i qytetarëve me përkatësi shqiptare është shumicë), ndërsa në Medvegjë kjo gjë do të arrihej me hapjen e njaftueshme të vendeve të punës për përkthyes e cila do të parashihej me Rregulloren mbi sistematizimin dhe organizimin e vendeve të punës në administratën komunale. Konsiderojmë që në këtë mënyrë shërbimi i lartpërmendur do të mundësojë zbatimin e Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve¹⁴ si dhe realizimin e të drejtave tjera të garantuara.¹⁵

⁹ “Gazeta zyrtare e RS”, nr. 72/2009.

¹⁰ Vendimi mbi përcaktimin e emërtimevetë vendbanimeve në gjuhën dhe shkrimin shqip për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, e publikuar në “Gazetën zyrtare RS”, nr. 118/2012 me datë 15.12.2012.

¹¹ “Gazeta zyrtare e rrethit të Pčinjës”, nr. 24/2008.

¹² “Gazeta zyrtare e rrethit të Pčinjës”, nr. 26/2008.

¹³ “Gazeta zyrtare e qytetit të Leskocit”, nr. 18/2008, 38/2012.

¹⁴ “Gazeta zyrtare e RS“ nr. 45/91, 53/93, 67/93, 48/94, 101/2005-dhe ligjet tjera, 30/2010.

¹⁵ **Shembuj:** akte vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik: Aktvendimi i lëshuar nga administrata komunale, nr. 08-465-378 me datë 19.01.2012; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale në Bujanoc, nr. 08-351-35 dt. 27.05.2013; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale në Preshevë, nr. 05.501-04/13 dt. 19.02.2013.; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale në Preshevë, nr. 04.351-56/13 dt. 29.07.2013.



Duke pasur parasysh që materniteti për banorët e komunës së Preshevës dhe Bujanocit gjendet në spitalin e Vranjës, dhe për komunën e Medvegjës gjendet në spitalin e Leskocit, nënat me përkatësi kombëtare shqiptare të cilat janë me vendbanim në këto komuna kryesisht lindin në Vranjë dhe Leskoc. Për këtë arsye regjistrimin e fëmijëve të posalindur në librat amëz të të lindurve është i obliguar t'ua lajmërojë institucioni shëndetësor në formularin e parashikuar pranë shërbimit të ofiqarisë të administratës komunale të qytetit të Vranjës dhe Leskocit. Megjithatë, pavarësisht faktit se në rendin juridik të Republikës së Serbisë e drejta e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për përdorimin e emrit personal është ngritur në nivel të të drejtave kushtetuese dhe më përafërt është rregulluar me ligj, zbatimi i kësaj të drejte në praktikë hasë në probleme të mëdha. Kështu, shumë persona kanë ankesa lidhur me punën e përditshme të shërbimit të ofiqarisë në administratat komunale të qytetit të Vranjës dhe të Leskocit ku janë vërejtur probleme në regjistrimin e fëmijëve në librat amëz e që kanë të bëjnë me shkrimin e emrave dhe mbiemrave në gjuhën shqipe dhe shkrimin latin (bastardimi i tyre), siç është paraparë me kushtetutë dhe ligj.

Në shërbimet e ofiqarisë të komunës së Preshevës, Bujanocit, Medvegjës, Vranjës, Leskocit dhe komunat tjera në territorin e Republikës së Serbisë, renditja e regjistrimit të emrit personal të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare në librin amëz të të lindurve me gjuhën dhe shkrimin shqip të cilit i takojnë nuk aplikohet në mënyrë të njëjtë. Në rastet në të cilat emri personal është shkruar në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik procedohet në shumë mënyra ndaj kërkesave për regjistrimin e emrit personal të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare në gjuhën amtare dhe shkrimin e saj – ndonjëherë me propozim për ndryshimin e emrit, e ndonjëher me kërkesë për përmirësimin e shënimit. Edhe pse Avokati i popullit i Republikës së Serbisë me Rekomandimin e tij nr. 16-166/11 të datës 16.03.2011 i ka rekomanduar Ministrisë për administratë shtetërore dhe vetadministrim lokal të Republikës Serbisë të ndërmarr masat e domosdoshme në kuadër të kompetencave të veta në mënyrë që shërbimet e ofiqarisë t'i zbatojnë drejtë dispozitat ligjore, më të cilat është përcaktuar mënyra dhe renditja e shënimit paralel të emrit personal të anëtarit të pakicës kombëtare në librin amëz të të lindurve, deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti vazhdon e nejtja praktikë e procedimit në të gjitha administratat komunale, pa përjashtim.¹⁶

Pjesëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare të cilët janë të lindur në komunat e lartpërmendura u lëshohen certifikatat e lindjes, kurorëzimit, vdekjes dhe vërtetime tjera të cilat janë të shënuara vetëm në gjuhën serbe dhe shkrim cirilik. Për shembull: në bazë të certifikatës së lindjes dhe

¹⁶ Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS nr. 16-166/11 i datës 16.03.2011; **Shembuj:** Certifikata e lindjes e dhënë në administratën komunale të Vranjës, nr. 200-1-0/2011-3-09 e datës 22.08.2011; Certifikata e lindjes e dhënë nga administrata komunale e Medvegjës, nr. 200-00-4/2013-31/81278 e datës 16.08.2013; Certifikata e lindjes e dhënë nga administrata komunale Savski Venac, numri personal 817, e datës 15.04.2011; Certifikata e lindjes e dhënë nga administrata komunale e Bujanocit, nr. 05-200/573 e datës 04.09.2013; Certifikatën e nënshtetësisë e dhënë nga administrata komunale e Bujanocit, nr. 204-1277/11 e datës 01.07.2011; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale e Bujanoc, nr. 201-124/11 dt. 03.10.2011; Aktvendimi për plotësimin e emrit personal, i dhënë nga administrata e Preshevës, nr. 01.201-35/13 i datës 29.04.2013.



certifikatës mbi shtetësinë¹⁷ Sekretariati i punëve të brendshme (SPM) emrat dhe mbiemrat ashtu të shkruar të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare i shënon edhe në letërnjoftim. Si pasojës e kësaj, vjen deri te një seri e lëshimeve gjatë shënimit të emrave në gjuhën dhe shkrimin shqip, si dhe shkeljen e të drejtës në identitetin personal të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare në Republikën e Serbisë.¹⁸

E drejta në emrin personal është njëra ndër të drejtat themelore e cila është ngritur në nivelin e garantimit kushtetues të të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta e Serbisë¹⁹, në nenin 37, paragrafi 3 proklamon që zgjedhja dhe shfrytëzimi i emrit personal dhe emrave të fëmijëve është zgjedhje e lirë. Për pjesëtarët e pakicave kombëtare Kushtetuta, në nenin 79 paragrafi 1, përmban garancinë shtesë të së drejtës në shfrytëzimin e emrit dhe mbiemrit të tij në gjuhën e amtare.

Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare në nenin 9 parasheh që anëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë në zgjedhje të lirë dhe shfrytëzim të emrit personal dhe emrit të fëmijëve të tyre, si dhe të drejtën e shënimit të këtij emri personal në të gjitha dokumentet publike, evidencat zyrtare dhe bazat e të dhënave në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare.

Gjithashtu, mbishkrimet e institucioneve shtetërore të cilat janë të disperzuara në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës janë të shënuara vetën në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, siç janë stacionet policore, enti republikan i gjeodezisë - shërbimi kadastral i paluajtshmërive, enti republikan për sigurimin shëndetësor, administrata tatimore e ministrisë së financave, filialet e shërbimit nacional për punësim dhe fondit republikan për sigurimet pensionale invalidore.

Enti republikan i gjeodezisë, përkatësisht shërbimi kadastral i paluajtshmërive në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, listat poseduese nga baza kadastrale e paluajtshmërive dhe dokumentet tjera të lëshuara i bën vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Ligji mbi përdorim zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve në nenin 11 paragrafi 1. dhe 2, parasheh që në territorin e njësisë së administratës lokale në të cilën tradicionalisht jetojnë pjesëtarë të pakicave kombëtare, gjuha dhe shkrimi i tyre mund të jetë në përdorim zyrtar të barabartë, ashtu që njësia e vetadministratës lokale gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare obligohet ta rregullojë me statut si gjuhë të barabartë në përdorim zyrtar nëse përqindja e pjesëtarëve të pakicës kombëtare nga numri i përgjithshëm i banorëve në territorin e vetë arrin 15% sipas regjistrimit të fundit të popullsisë. Derisa paragrafi 3 i këtij neni parasheh që përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare nga paragrafi 1 i këtij neni nënkupton ndër të tjera dhënien e dokumenteve publike dhe mbajtjen e evidencës zyrtare, si dhe format e të dhënave personale në gjuhët e pakicave kombëtare dhe pranimin e këtyre dokumenteve në ato gjuhë si të vlefshme.

¹⁷ **Shembuj:** Çertifikata e nënshtetësisë e dhënë nga administrata komunale e Bujanocit, nr. 05-204/478 dt.05.09.2013.

¹⁸ Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS, nr. 16-166/11 me datë 16.03.2011.

¹⁹ “Gazeta zyrtare e RS”, nr. 98/2006.



Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare në nenin 11. alinea 4. shprehimisht parashikon që përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe shkrimeve të pakicave kombëtare nënkupton dhënien e dokumenteve publike dhe mbajtjen e evidencave zyrtare, si dhe të dhënat personale në gjuhët e pakicave kombëtare dhe pranimin e këtyre dokumenteve në këto gjuhë si të vlefshme.

Vlen të theksohet që në komunën e Medvegjës edhe pse gjuha shqipe me statutin e komunës është parashikuar të jetë në përdorim zyrtar, në shërbimin e administratës së përgjithshme nuk është i punësuar asnjë anëtar i përkatësisë kombëtare shqiptare si ofiqar, që është parakusht i dhënies së certifikatës edhe në gjuhën shqipe. Gjithsesi, njëra ndër shkeljet më të rënda të dispozitave ligjore dhe statutare është mospublikimi i vendimeve komunale nga ana e komunës së Medvegjës edhe në gjuhën shqipe.²⁰

Gjithashtu në stacionet policore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë të gjithë formularët dhe procedurat administrative ndaj palëve të cilat janë pjesëtarë të përkatësisë kombëtare shqiptare udhëhiqen vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nga se në administratën e stacioneve policore nuk ka të punësuar persona të përkatësisë kombëtare shqiptare, sikur që në Rregulloren mbi sistematizimin dhe organizimin e vendeve të punës nuk janë parashikuar vende pune për përkthyes. Kështu që me dispozitën e nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve është rregulluar që formularët e evidencave për nevojën e territorit në të cilin është në përdorim zyrtar gjuha e pakicës kombëtare, të botohen në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe në gjuhën e pakicës kombëtare gjuha e së cilës është në përdorim zyrtar. Në këtë kuptim ekziston obligimi i organeve administrative të stacionit policor në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, për t'i lëshuar vendimet dhe vërtetimet në dy gjuhë në bazë të letërnjoftimeve dhe vendbanimeve të dhëna, përkatësisht edhe në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj.

Mbi bazën e kësaj Këshilli ka paraqitur kërkesë te Avokati i popullit i Republikës së Serbisë për fillimin e procedurës ndaj Ministrisë së punëve të brendshme e cila është duke u zhvilluar ende.²¹

Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit nuk zbatohet në asnjë ndërmarrje publike në komunat e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës si dhe as në qendrat mjekësore në këto komuna,

²⁰ Statuti i komunës së Preshevës i publikuar në ("Gazetën zyrtare të qytetit të Leskocit", nr. 18/2008, 38/2012).
Shembuj: Çertifikata e lindjes e lëshuar nga administrata komunale Medvegjë, nr. 200-00-4/2013-31/81278 dt. 16.08.2013.

²¹ Numri lëndës tek Avokati i popullit është 16-1813/13; **Shembuj:** Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nr. 27-2609/12-103 me datë 26.12.2012; Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nr. 205-99/11k me datë 05.05.2011; Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nr. 205-384/12 me datë 20.02.2013; 205-27/13p me datë 30.05.2013; Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik 205-98/13 me datë 27.05.2013.



sikur që as raportet mjekësore nuk lëshohen në dy gjuhë. Nga ana tjetër entet republikane dhe shërbimet tjera publike të cilat veprojnë në këto komuna, ndaj palëve të përkatësisë kombëtare shqiptare në asnjë rast nuk kanë aplikuar dygjuhësinë si gjuhë e barabartë në përdorim e parashikuar me ligj.²²

Me hyrjen në fuqi të Ligjeve mbi rregullimin e gjykatave të vitit 2008, aplikimi i të cilëve ka filluar me datë 1 janar 2010, së bashku me Ligjin mbi selitë dhe territoret e gjykatave dhe prokurorive publike të vitit 2008 kanë sjellë probleme serioze në funksionimin dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare me vendbanim në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, para së gjithash për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj në procedurat gjyqësore pranë gjykatës përkatëse. Në gjykatën themelore në Vranjë, në të cilën si njësi themelore janë kyçur gjykatat e deriatëhershme të komunës së Preshevës dhe Bujanocit, janë emëruar 5 gjykatës të përkatësisë kombëtare shqiptare, në raport me numrin e përgjithshëm prej 43 gjyqtarëve të paraparë për Gjykatën themelore, janë vetëm 11,62%. Duke ditur se Gjykata themelore mbulon 7 komuna të rrethit të Pçinjes ku më shumë se 25% të numrit përgjithshëm të banorëve që jetojnë janë anëtarë të pakicës kombëtare shqiptare, në këtë kuptim numri i përmendur i gjyqtarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare është i pamjaftueshëm që të sigurohet aplikimi kualitativ i dygjuhësisë. Deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti, përveç një procedure e cila është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj në Gjykatën themelore në Vranjë - njësi gjyqësore Preshevë, të gjitha procedurat tjera në gjykata janë udhëhequr vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik; po e njëjta situatë mbretëron edhe në prokurori.

Paketa e re ligjore për reformën e gjyqësorit e aprovuar në seancën e rregullt të Kuvendit të Republikës së Serbisë më datë 20 nëntor 2013, përfshirë Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi prokurorinë publike, Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi gjykatësit, Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi rregullimin e gjykatave si dhe Ligjin mbi selitë dhe territorin e gjykatave dhe prokurorive publike të cilët në mes të tjerash parashohin edhe rrjetin e gjykatave themelore dhe për kundërvajtje, në komunat në të cilat gjuha shqipe është në përdorim zyrtar: në nenin 2, paragrafi 1, pika 6) nuk parashihet Gjykata për kundërvajtje me seli në Bujanoc, por në vend të kësaj do të jetë njësi gjyqësore në Bujanoc e Gjykatës për kundërvajtje e Vranjës, nga ana tjetër sipas të njejtit nen dhe paragraf në pikën 30) parashihet që në Preshevë sikur deri më tani të jetë Gjykata për kundërvajtje. Sipas nenit 3, paragrafit 1, pika 10) në Bujanoc do të jetë Gjykata themelore, për territorin e komunës së Bujanocit dhe Preshevës, por këto zgjidhje ligjore nuk parashohin që komuna e Preshevës të ketë Gjykatën themelore me seli në komunën e saj, si parakusht për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj, e njëjta vlen edhe për komunën e Medvegjës për të cilën nuk është paraparë

²² Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS, nr. 16-998/12 od 13.07.2012.



Gjykata themelore. Sipas ligjit të lartpërmendur në nenin 9, paragrafi, 1 pika 14) për territorin e Gjykatës themelore të Bujanocit me njësinë gjyqësore në Preshevë, kompetente është parashikuar të jetë Prokuroria publike themelore me seli në komunën e Vranjës, përkatësisht me njësinë e saj në Bujanoc. Ky strukturim i rrjetëzimit të gjykatave dhe prokurorive e pamundëson realizimin e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj në këtë degë të pushtetit.

Për shkak të moszbatimit të Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve nga ana e Agjencionit për regjistrat ekonomike, përkatësisht për shkak të mungesave serioze në dispozitat e Ligjit mbi procedurën e regjistrimit në agjencionin për regjistrat ekonomike²³ në kuptimin e mos parashikimit të shënimit të emërimit të subjekteve ekonomike edhe në gjuhën e pakicave kombëtare, dhe si pasojë e kësaj ka ardhur deri tek ngritja e disa procedurave kundërvajtëse gjyqësore ndaj subjekteve ekonomike të cilat emrin emrin e tyre pranë gjuhës serbe e kanë shkruar edhe në gjuhën shqipe në ato komuna në të cilat me ligj është i garantuar përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj. Shembull: procedurat gjyqësore në Gjykatën për kundërvajtje në Preshevë dhe në Gjykatën për kundërvajtje në Vranjë - njësia gjyqësore në Bujanoc.

Në praktikë dhe në procedurën e regjistrimit të shoqatave nga radhët e pakicave kombëtare janë vërejtur probleme serioze në zbatimin e Ligjit mbi shoqatat,²⁴ si edhe gjatë lajmërimeve të publikuara në portalin e Agjencionit për regjistrat ekonomike (e cila është e obliguar t'i udhëheq edhe regjistrat e shoqatave). Pra, në internet faqen zyrtare të Agjencionit, nuk ka asnjë lajmërim dhe as formular për paraqitjen e kërkesës në gjuhët e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar në territorin e komunave të cilat i mbulojnë njësitë organizative të Agjencionit për regjistrat ekonomike.

Ligji mbi shoqatat në nenin 13 parshikon që vetëm: „Emri i shoqatës, nëse kjo është paraparë me statut, mund të jetë edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare. Emri në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare shënohet në regjistër pas shënimit në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.“ Megjithatë, as Ligji, e as rregulloret përcjellëse të Ministrisë për administratë shtetërore mbi përmbajtjen, mënyrën e shënimit dhe udhëheqjes së Regjistrit të shoqatave nuk përmbajnë dispozita me të cilat rregullohet procedimi i zyrtarit të autorizuar ndaj kërkesave me aktet themeluese të cilat i nxjerrin palët në gjuhën e pakicave. Në këtë mënyrë praktikisht është pamundësuar gëzimi i të drejtave për pjesëtarët e pakicave kombëtare që si të vlefshme t'i paraqesin dokumentet në gjuhën dhe shkrimin e tyre, nëse e njëjta është në përdorim zyrtar në

²³ “Gazeta zyrtare e RS”, nr. 99/2011.

²⁴ “Gazeta zyrtare e RS”, nr. 51/2009 dhe 99/2011 – ligjet tjera.



territorin në të cilin shtrihet ky organ apo shërbim, që në këtë rast është njësia organizative e Agjencionit për regjistrat ekonomikë.

Në fund, por jo më pak e rëndësishme vlen të theksohet që në zgjedhjet lokale dhe parlamentare të mbajtura me 6 Maj të 2012-tës, në komunën e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës në të cilat me statut gjuha shqipe me shkrimin e saj është në përdorim zyrtar, materiali zgjedhor së bashku me evidencat e qytetarëve kanë qenë vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Këshilli në pajtim me Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare ka aprovuar propozimin mbi përcaktimin e festave zyrtare për pakicën shqiptare në Republikën e Serbisë. Propozimi në fjalë gjatë muajit gusht është dërguar Këshillit për pakica kombëtare i themeluar me Vendimin²⁵, por ne, si Këshill nacional i shqiptarëve deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti, ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje dhe rrjedhimisht festat zyrtare për pakicën kombëtare shqiptare në Serbi me neglizhimin e Këshillit në fjalë kanë mbetur të pa përcaktuara.

Këshilli nacional i pakicës kombëtare shqiptare do të angazhohet edhe në të ardhmen që, përmes zgjidhjeve ligjore të parashikuara, së bashku me institucionet relevante në nivel vendi, përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit të jetë i realizuar, si dhe në të njëjtën kohë vendosja efektive e mekanizmave në administratën shtetërore për realizimin e të drejtave individuale dhe kolektive është prioritet i Këshillit.

Këshilli nacional i pakicës kombëtare shqiptare, gjithashtu, ka në agjendën e tij edhe rregullimin e çështjes së përdorimit të simboleve kombëtare. Kjo çështje është rregulluar me nenin 16 të Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare. Edhe pse, në parim, kjo çështje pretendohet se është rregulluar, pakica shqiptare në Serbi është e pakënaqur me këtë zgjidhje juridike, pasi që alineja 2 e nenit 16 të Ligjit në fjalë kufizon përdorimin e simboleve kombëtare me që dispozita kontestuese kërkon që simbolet të mos jenë identike me ato të shteteve tjera.

Për pakicën kombëtare shqiptare një zgjidhje e tillë është e papranueshme dhe ne pandërprerë kemi kërkuar dhe do të kërkojmë që përdorimi i simboleve kombëtare të bëhet pa kurrfarë kufizimesh. Në këtë aspekt, Kuvendi i Republikës së Serbisë në përputhje me kërkesën tonë

²⁵ “Gazeta zyrtare e RS”, nr 46/2013



duhet ta ndryshojë këtë dispozitë sa më shpejt që është e mundur, me çka do të tejkalohet ky problem dhe me të cilën shqiptarëve do t'i njihet një e drejtë elementare. Në këtë drejtim, do të kërkojmë edhe nga faktori ndërkombëtar ndihmën dhe mbështetjen në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

K R Y E T A R

Galip Beqiri